



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:024881

Datë: 24.02.2020

Numri i dokumentit: 00850526

P.nr.1056/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarës Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e zyrtarës ligjore Bute Noci, në çështjen juridikopenale kundër të akuzuarit, R. B. me vendbanim në fsh.K., për shkak të veprës penale, të kanosjes nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2133/2017 të dt. 10.10.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, me dt.23.01.2020, në prezencën e Prokurorit të shtetit, Lumturije Hoxha, të akuzuarit R. B. dhe të dëmtuarit A. K. dhe me dt.28.01.2020, murr, publikisht shpalli dhe me dt. 21.02.2020 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

R. B., i lindur me në fsh. K....., nga babai I. dhe nëna H. e gjinisë S., ka të kryer fakultetin Teknik, me profesion inxhinier, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar sipas letërnjoftimit me nr. personal, lëshuar nga MPB - Prishtinë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

-Me datë 25.08.2017, rreth orës 17:20, në rr. “.....” në, seriozisht e kanos të dëmtuarin A. K., në atë mënyrë që ditën kritike, pas një mosmarrëveshje në mes tyre lidhur me listën për pajisje me uniforma zyrtare, i pandehuri përmes telefonit i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “kam me ta ba hajmalin dhe kam me të dal nënshkrim mbi nënshkrim, e pastaj që ti po shet shkokla e sheh çka ka me të dal qe kjo fjalë”, me ç ’rast, ky i fundit e lajmëron rastin në polici,

- me çka ka kryer veprën penale, të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par, 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par.1 nën par. 1.2, 50, 51, 52, 73, 74, dhe neni 185 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ja përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një (1) viti, nuk do të kryen vepër tjetër penale.

I akuzuari obligohet të paguaj, shpenzimet për paushallin gjyqësor, shumën prej dyzet (40) euro dhe taksën në shumë prej tridhjetë (30) euro, për kompensimin e viktimave të krimit, krejt këtë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari A. K., nga, rr. “", për realizimin e kompensimit të dëmit udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II.nr.2133/2017 të dt. 10.10.2017, kundër të akuzuarit R. B., për shkak të veprës penale, *të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.*

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit, të akuzuarit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, ku i akuzuari u njoftua me të drejtat e tij, nga neni 323 të KPPRK-së, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 325 të KPPRK-së, të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, të KPPRK-së, kështu që i akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, ashtu që gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave.

Në kuptim të nenit 327 të KPPRK-së, gjykata i ofron mundësinë prokurorit të shtetit, palës së dëmtuar dhe të akuzuarit, të japin fjalën hyrëse të tyre dhe pas dëgjimit të fjalës hyrëse, gjykata në procedurën e provave ka dëgjuar të dëmtuarin A. K., ka dëgjuar dëshmitarët, A. Sh. dhe A. Th., dhe janë lexuar këto prova materiale: Raporti S. B. i dt. 25.08.2017, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me dt. 25.08.2017 dhe me dt. 29.08.2017, deklarata e të akuzuarit e dhënë në polici me dt. 26.08.2017 dhe 31 .8.2017, lista e punëtorëve të-it, për rrobat-uniformat e veres, si dhe shkresat tjera të lëndës dhe së fundi është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit.

Fjala përfundimtare

Prokurori i shtetit në fjalën e përfundimtare ka deklarua se: gjatë shqyrtimit gjyqësor, në këtë çështje penale, kryesisht dëshmisë së të dëmtuarit A. K.si dhe vet deklaratës së të akuzuarit R. B., u vërtetua se i njëjti është kryes i veprës penale të lartcekur. I dëmtuari ka deklarua se i tërë problemi ka ardhur si pasojë e shpërndarjes së uniformave në-, dhe kur është bërë shpërndarja i dëmtuari ka qenë në pushim vjetor, dhe pasi që është kthyer nga pushimi, zyrtari i burimeve njerëzore B. G., e ka akuzuar pse nuk po e vesh uniformën, dhe pasi që i ka tregua se nuk e ka marr uniformën ai e ka ftuar në zyrën e tij ku në regjistër ka figurua se unë e kishte marr uniformën, sepse në rubrikën e tij figuronte nënshkrimi i të akuzuarit R. B., i cili ka qenë koordinator i tij. Pasi që i njëjti ka ardhur në zyrën e tij i është drejtuar me fjalët se “nuk ka shtet që më shkel mua”, për këtë shkak i dëmtuari ka lajmëruar rastin në polici, dhe i pandehuri menjëherë e ka ftuar në telefon, e ka kanosur me fjalët “ki me pësua keq, kam me ta ba hajmalinë, kush je ti që lyp e tjerr kaq fort”, dhe shumë fjalë të tjera, e të cilat i njëjti i ka të ruajtura në CD si dëshmi. Prokurorja më tutje sqaron se fjala “kam me ta ba hajmalinë, për të dëmtuarin ka qenë dëmtim profesional, për shkak se menjëherë pas rastit e kanë transferuar në Deçan”, për çka i dëmtuari ka mbetur pa punë.

Më tutje, elaboron se, i akuzuari në mbrojtjen e tij nuk e mohon ta ketë ftuar në telefon të dëmtuarin duke deklaruar se i kam thënë, “shko merre uniformën dhe mos e refuzo urdhëresën sepse ta shkruaj fletëparaqitjen dhe pasojat do ti kesh më të mëdha”, mirëpo të njëjtit nuk i kujtohet se ai ka thënë “ka me të dal nënshkrim mbi nënshkrim”, gjithashtu nuk i kujtohet ti ketë thënë “ta bëj hajmalinë”, i njëjti gjatë gjithë kohës për ti ikur përgjegjësisë penale ka mohua ta ketë kryer veprën penale në fjalë.

Andaj, nga të lartcekurat erdhi në përfundim se, në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, ku në rastin konkret është realizua pasoja e kësaj vepre, sepse të dëmtuarit i është bërë transferi i vendit të punës, andaj i propozon gjykatës që deklaratës së të akuzuarit mos ti fal besimin, për shkak se i njëjti ka për qëllim ikjes së përgjegjësisë penale, propozon që, i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, gjithashtu të ngarkohet me shpenzimet procedurale.

I dëmtuar në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se, e përkrahi fjalën përfundimtare prokurores, njëherit shton se, nga rasti në fjalë e ka ndie veten të dëmtuar pasi që pas rastit që ka ndodh ka mbetur pa punë dhe po ti jipet mundësia do të kthehet përsëri në vendin e punës, pasi që tani nuk është i akuzuari R. B., koordinator në-Pejë, dhe njëherit do të kërkon kompensimin e pagave për atë që është jashtë procesit të punës.

I akuzuari në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se, mbet pranë deklaratave të dhëna në polici dhe në gjykatë, nuk ka çka të shton.

Gjendja e vërtetuar faktike

Gjykata pas analizimit të provave dhe vlerësimit të tyre të gjithanshëm, secilës veç e veç e në lidhje reciproke me provat tjera, konform nenit 361 par.1 2 të KPPRK-së, dhe pas vlerësimit të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike.

-Se me datë 25.08.2017, rreth orës 17:20, në rr. “.....” në, seriozisht e kanos të dëmtuarin A. K., në atë mënyrë që ditën kritike, pas një mosmarrëveshje në mes tyre lidhur me listën për pajisje me uniforma zyrtare, i pandehuri përmes telefonit i drejtohet të dëmtuarit me fjalët “kam me ta ba hajmalin dhe kam me të dal nënshkrim mbi nënshkrim, e pastaj që ti po she t shkokla e sheh çka ka me të dal qe kjo fjalë”, me ç’rast, ky i fundit e lajmëron rastin në polici,

Kjo gjendje faktike u vërtetua edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve: A. Sh.dhe A. Th., dhe janë lexuar këto prova materiale: Raporti S. B.i dt. 25.08.2017, deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me dt. 25.08.2017 dhe me dt. 29.08.2017, deklarata e të akuzuarit e dhënë në polici me dt. 26.08.2017 dhe 31 .8.2017, lista e punëtorëve të-it, për rrobat-uniformat e veres, si dhe shkresat tjera të lëndës dhe së fundi është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit.

Sa i përket propozimit të dëmtuarit që gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata të administroj si provë materiale CD-në, për ta dëgjuar bisedën që ishte zhvilluar në mes të dëmtuarit A. K.dhe të akuzuarit R. B., gjykata e refuzoj një propozim të tillë pasi që një propozim të tillë i dëmtuari e kishte bërë edhe në polici dhe në prokurori tek prokurorja e çështjes, e që një propozim i tillë nuk ishte marr për bazë as nga policia e as nga prokuroria, ndërsa e aprovoj propozimin e tij që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen A. Sh.dhe A. Th..

Administrimi i provave

Nga raporti i policit S. B., i dt. 25.08.2017, rrjedh, se me drt. 25.08.2017, ankuesi A. K.ka raportua për rastin për çka i njëjti është intervistua, ku derisa ishte në vendin e punës në-personi zyrtar B. G., e ka pyet për uniformen verore , ndërsa A.i përgjigjet se nuk jam ngarkua me uniform verore për shkak se, në atë kohë kishte qenë në pushim mjekësor dhe se nuk e ka nënshkruara listën, ku figuron edhe nënshkrimi i A. K. dhe se përgjegjës është koordinatori R. B..

Nga lista e punëtorëve të-it, për rrobat – uniformat e veres, shifet se i dëmtuari A. K. është i 13 –ti me radh, për çka nuk e ka mohuar faktin se e ka nënshkruar vetë i akuzuari R. B..

Gjykata, duke u bazuar në këto dëshmi –prova materiale, për të cilat nuk ka dilema për faktet të cilat janë vërtetuar, këtyre provave ju fali besimin e plotë, e të cilat janë në lidhje logjike dhe reciproke me njëra tjetrën.

I dëmtuari A. K., e gjatë shqyrtimit gjyqësor por edhe në prokurori dhe polici, ka deklaruar se, ka qenë në pushim mjekësor, diku në muajin gusht apo shtator i viti 2017, ku gjatë kësaj kohe ishin shpërnda uniformat zyrtare për punëtorët e, uniformen nuk e ka marr pasi që ka qenë në pushim edhe kur është kthyer në punë, zyrtari i burimeve njerëzore B. G., e ka pyet pse nuk e ka vesh uniformen, i ka tregu se nuk e ka marr uniformen, e ka ftua në zyre ku ai e kishte regjistruar ku figuronte se, ai e kishte marr uniformen dhe se ishte nënshkrua dikush në rubrikën e tij. Andaj është interesua se ku ka shkuar uniforma e tij, i

kujt është nënshkrimi dhe e ka lajmërua policinë për falsifikim të nënshkrimit, sepse uniformen nuk e ka marr. Policia e ka vazhdua punën dhe e ka marr koordinatorin. Pas kësaj, ka ardh

koordinatori në zyre ku aty kanë qenë edhe punëtorëve A. Sh. dhe A. Th., duke i thënë: “nuk ka ligj që më shkel mua”. Pas disa ditëve e ka thirr dikush nga policia dhe i ka thënë se, jam nga policia dhe se uniformen e ki te M. K.(për të cilin nuk e dinë se a është duke punuar ende në), mirëpo nuk mund ta merr tek ai uniformen pasi është në të njëjtin rang, ashtu që duhet ta merr tek personi përgjegjës. Pas 2-3 minuta, e ka thirr në telefon koordinatori, i cili i ka thënë përmes telefonit, “ki me pësu keq, kam me ta ba hajmalinë, kush je ti që e lyp e tjerr kaq fort”, dhe disa fjalë të cilat i ka të incizuara në telefon, ku e ka incizuar veten dhe ku dëgjohet i pandehuri si i është drejtuar përmes telefonit dhe për këtë shton se, e ka njoftua edhe policinë dhe prokurorinë, por nuk është në dijeni dhe nuk e dinë arsyen se, pse nuk është konstatua në deklaratën e dhënë polici dhe prokurori. Deklaron se fjalën hajmalinë e ka kuptuar si kërcënim fizik dhe dëmtim profesional çka edhe ka ndodhur, pasi që kanë dashtë me transferua në Deçan.

Gjykata vlerësoi deklaratën e të dëmtuarit, deklaratës së tij ia fali besimin e plotë, pasi që i njëjti, në detaje ka sqarua se për fjalën “kam me ta ba hajmalinë”.....etj, ndihet seriozisht i kërcënuar por edhe në aspektin fizik se mund ti bëjë ndonjë të keqe, e po ashtu edhe në punë pasi që të akuzuarin e kishte udhëheqës, dhe si pasojë e kësaj ishte transferuar në nëndistrikthin – Deçan dhe pastaj kishte mbetur pa punë, këtë e vërtetoi edhe dëshmitari A. Th., pasi që i njëjti kishte deklaruar se i dëmtuari Arben ishte ankuar tek ai dhe nga presioni i të akuzuarit e kishte lëshuar punën. Mirëpo faktin se të dëmtuarit i është bërë transferi nuk e mohon as i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka dëgjuar dëshmitarin Albert Shala, i njëjti ka deklaruar se, nuk i kujtohet se i akuzuari i ka thënë: “nuk ka limë as shtet që më han mua, se unë jam më i fortë”. Në mëngjes zakonisht takohen në ora 8:30, gjithë stafi në zyrën e koordinatorsit dhe pasi që i marrin urdhëratë nga koordinatori dalin në teren dhe kthehen në ora 16:30, për çka nuk është në dijeni për mosmarrëveshje apo se çka ka ndodh në mes tyre. Ka njohuri pse A.e ka lëshuar punën, mirëpo as A. e as R. nuk i kanë treguar se kanë pasur mosmarrëveshje, raportet me stafin i ka pas të mira për të tjerët nuk kishte njohuri.

Gjykata vlerësoi dëshminë e dëshmitarit, mirëpo nga kjo dëshmi, gjykata nuk pati mundësi të vërtetoi se i akuzuari i është drejtuar me fjalët kërcënuese, edhe pse dëshmitari kishte deklarua se, ishte prezent gjithë stafi në zyre ku çdo mëngjes kur kishin marr urdhra nga koordinatori për punën e tyre, e as nuk kishte njohuri se kishin pas mosmarrëveshje i dëmtuari me të akuzuarin në mes vete, dhe pse e kishte lëshua punën i dëmtuari,, andaj, gjykata deklaratën e këtij dëshmitari nuk e morri parasysh.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka dëgjuar edhe dëshmitarin A. Th., i njëjti ka deklaruar se, i akuzuari R. B.me të dëmtuarin A. K., kishin pas fjalosje në zyre, mirëpo menjëherë ka dal nga zyra sepse R. e ka pas shef dhe A.n e ka pas kushëri dhe nuk ka dashtë me qenë pjesë e kësaj ngjarje në atë moment. Me të akuzuarin R. B.i ka raportet e mira, ka dy vite që nuk janë takuar pasi që tani R. punon në Sa i përket A., para dy vite sa i kujtohet nuk punon, nuk e din arsyen se pse e

ka lëshuar punën, ndoshta edhe nga problemi që i ka ndodhur (mosmarrëveshje me të akuzuarin). Nuk i kujtohet se a është takuar me R. pasi ka dal A. nga puna. Nuk ka njohuri se a e ka lëshua A. punën vet apo e ka largu dikush.

Në mes tjerash ka deklarua se, ditën kritike i kujtohet se, në një zyre të veçantë të-it, ku prezentë ishin R. dhe A., ndoshta ka qenë edhe dikush tjetër por për momentin nuk i kujtohet, diçka ka dëgjua se janë fjalos, nuk i kujtohen fjalët dhe menjëherë ka dal nga zyra. Pastaj nuk i kujtohet çka ka ndodh, por nuk është në dijeni se a ka ardh A. në punë pas asaj dite. Nuk është dijeni se, a e ka lëshuar me vet dëshirë, apo me urdhrin e ndonjë eprori, por e din se ka pas me kalua në nëndistriktin në dhe se nuk ka dijeni se a ka vazhdua me punua në, dhe afërsisht qe dy vjet nuk punon në Shton se A. sigurisht i ka arsytet e veta se pse e ka lëshu punën në, është ankuar për R. se i ka bërë presion dhe e ka kërcënuar dhe për këtë e ka lëshuar punën.

Gjykata pati parasysh deklaratën e dëshmitarit, të njëjtën e vlerësoi, deklaratës së këtij dëshmitari ja fali besimin, pasi që përputhet me deklarinimin e te dëmtuarit dhe atë të akuzuarit se ishte bërë transferimi i A. në nëndistriktin, e si pasojë e kësaj kishte mbetur i dëmtuari pa punë, (si e drejtë elementare). Mirëpo i njëjti edhe pse fillimisht mohoi të ketë njohuri për mosmarrëveshje që kishin pasur në mes vedit, në një moment deklaroi se A. ishte ankua tek këtu dëshmitari A., se kishte pasur presion nga i akuzuari, se e kishte kërcënuar dhe për këtë e kishte lëshuar punën, e një gjë e tillë vazhdon edhe sot.

Nga mbrojtja e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar se, ka qenë koordinator i nëndistriktit-Pejë, ku ka veprua sipas rregullores së punës dhe Ligjit të punës. Për 10 vite ka punuar në Pejë, dhe gjatë kësaj kohe asnjëherë nuk e ka kërcënuar askënd. Ditën kritike nuk ka ndodh asnjë send, nuk ka pas as kërcënim. Mirëpo para kësaj dite kur A. ishte në pushim, në depo të-it, kanë ardh uniformat për 48 punëtor të-it, unë në bazë të kompetencave jam ngarkuar me to dhe kam filluar shpërndarjen e tyre. Të gjithë punëtorët i kanë uniformat ndërsa A. ka munguar ngase i njëjti ka qenë në pushim vjetor apo mjekësor nuk e di saktë. Uniformen e A. e kam vendosur në sirtarin tim në zyre, përderisa të kthehet A.. Pas shpërndarjes së uniformave dhe lënies në sirtar, depoisti K. A. nëse më kujtohet, ma ka kërkuar listën e konfirmimit të pranimit të uniformave, unë i kam treguar depoistit se në listë figuron emri i A. por uniformen nuk e ka marr pasi që i njëjti ka qenë në pushim. Ndërsa depoisti i ka preferua ta bëjë një shenjë apo nënshkrim si lloj konfirmimi për ta dërguar në Prishtinë. Unë ashtu veprua dhe e përçolla listën. Nuk e di saktë se kur është kthyer A. në punë dhe në zyre në praninë e punëtorëve të tjerë i kam ofruar me e marr uniformen. A. ka kundërshtuar ta pranojë uniformen me pretekst se nënshkrimi i është falsifikuar dhe ka dal nga zyra. Ne nuk jemi fjalosur në mes vete. Pas kësaj drejtori B. E., ka sugjerua që uniformen e A. ta dërgoj tek B. G. i cili është përgjegjës për siguri në punë, unë e kam dërguar edhe e kam thirr A. në telefon dhe e kam urdhëruar që të shkojë dhe ta marr uniformen, A. në telefon më ka thënë se “unë nuk shkoj me marr uniformen e du nënshkrimin dhe procedurën”. Ndërsa unë i kam thënë shko te B. G., e ki uniformen e merre dhe mos e refuzo urdhëresën sepse ta shkruaj fletëparaqitjen dhe pasojat do ti kesh më të mëdha dhe e kam mbyll telefonin.

Më tutje ka deklarua se, nuk i kujtohet ti ketë thënë të dëmtuarit “ka me të dal nënshkrim e mbi nënshkrim, çka po qet shokla, e sheh çka ka me të dal çekjo fjalë”, dhe pas kësaj ngjarje pas dy –tre, muaj ka dal A.nga puna. Shton se, transferin për ndryshimin e vendeve të punës i ka bërë menaxhmenti i Prishtinës në bashkëpunim me drejtorin e distriktit në Pejë. Ndërsa në i akuzuari është transferuar me dt. 03.03.2018, pa dëshirën e tij. I dëmtuari A. është e vërtetë se ka qenë në listen për marrjen e uniformes, por nuk ka qenë obligative me u nënshkru pasi që i akuzuari ka qenë i ngarkuar me shpërndarjen e uniformave.

Në mes tjerash, ka deklaruar se, sipas kompetencave të tija të atëhershme çdo refuzim i urdhëresës së tij, ka pas të drejtë të bëjë fletëparaqitje për refuzim të urdhëresës dhe arbitër për këto fletëparaqitje ishte drejtori, nga se vendimet për fletëparaqitje i ka marr drejtori në raste të tilla B. E.. Nuk i kujtohet se i ka thënë “ta bëjë hajmalinë” dhe fjalët e cituara më lartë, por “do të shkruaj fletëparaqitje dhe pasojat do të jenë shumë të rënda, nga se në bazë të fletëparaqitjes mund të merr edhe vërejtje me gojë, me shkrim dhe nëse është shkelja e rëndë edhe largimi nga puna”, për çka kompetent është drejtori. Shton se kur asnjëherë, në asnjë rast, në asnjë formë nuk ka pas as qëllim e as nuk është në natyrën e tij që të kërcënoj dikë me as një fjalë e as në ndonjë mënyrë. Në rastin e A. K. transferi është bërë varësisht prej nevojave të kompanisë, menaxhmenti i Prishtinës në bashkëpunim me drejtorin e nëndistriktit i bëjnë këto lëvizje, duke shtuar se në këtë mënyrë edhe vetë është transferuar.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuari R. B., i cili mohon kryerjen e veprës penale, mirëpo të njëjtën mbrojtje gjykata e hodhi poshtë si të pa bazuar, duke qenë se i akuzuari e mohon të ketë kryer veprën penale, edhe pse pranon ti ketë thënë të dëmtuarit“e ki uniformen e merre dhe mos e refuzo urdhëresën sepse ta shkruaj fletëparaqitjen dhe pasojat do ti kesh më të mëdha”....., ndërsa nuk i kujtohet ti ketë thënë “ka me të dal nënshkrim mbi nënshkrim,.....”,ta bëjë hajmalinë”.....”po shet shokla, e sheh çka ka me të dal çekjo fjalë”....., të cilat fjalë i dëmtuari A. i ka marr si kërcënuese dhe si pasoj e kësaj, pas fjalosjes është transferuar në nëndistriktin –Deçan, për çka i njëjti ka refuzuar dhe ka mbetur pa punë.

Sa i përket nënshkrimit të listës së uniformave, për gjykatën nuk ishte kontestues, i akuzuari nuk e ka mohuar faktin se ka nënshkruar për A., për çka gjykatës i ka dhënë arsyet e veta, pasi që lista është dashur të shkoj për Prishtinë.

Nga këto arsye gjykata ka gjetur se, mbrojtja e të pandehurit është e orientuar në shmangie të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, nga se nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike si është përshkruar në këtë aktgjykim, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale *kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së*.

Sa i përket fajësisë, i akuzuari ka veprua me dashje, duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të veta dhe duke e dëshiruar shkaktimin e pasojave të cilat edhe i realizoi, andaj gjykata të njëjtin e gjeti fajtor dhe penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale në fjalë.

Në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do të ishte me ndikim për zvogëlimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit, prandaj të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar faktin se, është kryefamiljar, baba i dy fëmijëve, i vetmi mbajtës i familjes. Si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata gjeti se, pas fjalosjes me të akuzuarin ka rezultuar me transferin e vendit të punës prej-Pejë në nëndistriktin Deçan, për çka i dëmtuari tani e dy vite si pasojë e kësaj ka mbetur pa punë. Si rrethanë rënduese, gjykata pati parasysh se rasti në fjalë ka ndodh në lokalet e Korporatës Energjetike --it-nëndistrikti –Pejë. Në prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe rrethane rënduese, të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është bindur se vendimi mbi dënimin, do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPRK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej dyzet (40) euro, dhe taksën në shumë prej tridhjetë (30) euro, konform, e konform nenit 39 të Ligjit 05/L-036, për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Gjkata për realizimin e kompensimit të dëmit, konform nenit 463 të KPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest të rregullt civil.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPRK-së, është vendosur si nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË –DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.1056/17 të datë 21.02.2020

Zyrtarja ligjore

G j y q t a r j a

Bute Noci

Florije Zatriqi

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:024881
Datë: 24.02.2020
Numri i dokumentit: 00850526